



Save the Children

**RAPORTI HULUMTUES I
ZRRF-së PËR LEGJISLACIONIN
DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE
TË INTERESIT NË KOSOVË**

NËNTOR 2018

Raporti Hulamtues i ZRRF-së për Legjislacionin dhe Përgjegjësitë e Palëve të Interesit në Kosovë

Raporti hulamtues i ZRRF-së për legjislacionin dhe përgjegjësitë e palëve të interesit në Kosovë. Ky studim u mbështet nga “Save the Children Kosovë” për të shqyrtuar kornizën ekzistuese ligjore dhe të politikave mbi Menaxhimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (MRRF) për të shpjeguar rolet dhe përgjegjësitë nëpër departamente të ndryshme kombëtare dhe komunale për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (ZRRF).

Falënderimi

Promovimi i Komuniteteve të Sigurta dhe të Qëndrueshme nga Fatkeqësitë në Kosovë, përmes ZRRF-së gjithëpërfshirëse të orientuar kah fëmijët është një projekt një vjeçar, i mbështetur nga “Save the Children Itali”. Në kuadër të këtij projekti, “Save the Children Kosovë” realizoi këtë Studim hulumtues për të shqyrtuar kornizën ekzistuese ligjore dhe të politikave për Menaxhimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (MRRF) për të shpjeguar rolet dhe përgjegjësitë e departamenteve të ndryshme kombëtare dhe komunale për zvogëlimin efektiv të rrezikut nga fatkeqësitë.

Ky studim u bë nga Znj. Shahida Arif, Këshilltare Ndërkombëtare ZRRF/Shefe e ZRRF-së dhe për Emergjencë, “Save the Children Pakistan”, me mbështetjen dhe ndihmën e:

- Z. Soso Bagashvili, Këshilltar rajonal për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe qëndrueshmëri, “Save the Children në Lindje të Mesme dhe Euroazi”
- Z. Kamal Ahmed, Trajner ndërkombëtar, “Save the Children Kosovë”

Gjithashtu, çmohet edhe përkrahja, lehtësimi dhe kontributi i ofruar nga ministritë, departamentet përkatëse dhe agjencitë e OKB-së, veçanërisht Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, Ministria e Arsimit, Ministria e Punëve të Brendshme, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe UNICEF etj. Sugjerimet e tyre të rëndësishme dhe informatat shumë-sektoriale përkatëse e bënë të mundur qartësimin e rolit të palëve të ndryshme të interesit në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Falënderime të veçanta për Komunën e Mitrovicës dhe atë të Gjilanit - Drejtoria e Arsimit, Menaxhimi i Emergjencave dhe Menaxhimi i shkollave për të kursyer kohën dhe për të ofruar ndihmë dhe lehtësim përmes burimeve të tyre. Pa mbështetjen e tyre, do të ishte pothuajse e pamundur të jepem rekomandimet e besueshme për strategjitë e propozuara për ZRRF në nivel komunal.

Akronimet dhe Shkurtesat

PRE	Plani i Reagimit ndaj Emergjencave
AME	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
RF	Reagimi ndaj Fatkeqësive
MRRF	Menaxhimi i Rrezikut ndaj Fatkeqësive
ZRRF	Zvogëlimi i Rrezikut ndaj Fatkeqësive
IJK	Intervistat e Informatorëve Kryesorë
TER	Termet e Referencës
UNISDR	Strategjia Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Fatkeqësive
VRR	Vlerësimi i Rrezikut
DME	Drejtoria për Menaxhimin e Emergjencave
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
DKSH	Drejtoria Komunale e Shëndetësisë
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
SIME	Sistemi i Integruar për Menaxhimin e Emergjencave
PMF	Plani për Menaxhimin e Fatkeqësive
OMF	Organizatrat për Menaxhimin e Fatkeqësive
SPH	Sistemi për Paralajmërim të Hershëm
PZRRF	Plani për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë
OSHC	Organizatrat e Shoqërisë Civile
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
SCI	“Save the Children International”
KKK	Kryqi i Kuq i Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
MRRFBK	Menaxhimi i Rrezikut ndaj Fatkeqësive me bazë në Komunitet
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KGJSSH	Korniza Gjithëpërfshirëse e Sigurisë në Shkollë
ORND	Organizata Ndërkombëtare
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizatrat Jo-Qeveritare

Përmbajtja

Falënderimi.....	2
Akronimet dhe Shkurtesat	3
1. Përmbledhja ekzekutive	5
2. Historiku	7
3. Objektivat dhe metodologjia	8
4. Profili i Rrezikshmërisë në Kosovë	9
5. Të gjeturat	11
6. Analiza dhe përfundimet.....	18
7. Strategjitë e propozuara	24
8. Rolet dhe Përgjegjësitë e propozuara	26
9. Shtojcat	33

1. Përmbledhja ekzekutive

Kosova është e ekspozuar si ndaj fatkeqësive hidrometeorologjike ashtu edhe atyre gjeologjike (vërshimet, reshjet e mëdha, thatësira, zjarri pyjor dhe tërmeti). Vërshimet e befasishme janë të zakonshme në zonat malore, të cilat në disa zona rezultojnë në rrëshqitje. Kosova gjithashtu është e ekspozuar ndaj rrëshqitjeve të dheut, veçanërisht në zonën e Mitrovicës, Prishtinës, Pejës dhe Shtërpcës. Të paktën një e katërta e komuniteteve janë të ndjeshme ndaj rrëshqitjeve të dheut dhe rënies së shkëmbinjve, derisa vërshimet e lumenjve ndikojnë në rrafshina. Shpërthimi i reve është një fenomen tjetër që kërcënon Prishtinën, Mitrovicën, Besianën dhe Gjakovën, për shkak të dobësisë strukturore të pendave. Në disa pellgje të lumenjve shumë të ekspozuar (si Drini në gjysmën perëndimore të vendit), vërshimet ndodhin çdo 2-3 vjet. Në vitin 1973, një vërshim i madh që goditi pjesën jugore të qytetit të Ferizajt. Nga nëntori i vitit 2007 deri në qershor të vitit 2008, tre vërshime zhvendosën 3,500 banorë dhe shkaktuan dëme në shtëpi dhe tokë bujqësore, të cilat shtruan nevojën për ndihmë humanitare nga bashkësia ndërkombëtare.

Për shkak të luhatjeve sezonale në reshje, prodhimi bujqësor në rajonet pa sistem alternativ të ujitjes preket rëndë. Kosova është ballafaquar me thatësira disa herë gjatë dy dekadave të fundit (1993, 2000, 2007 dhe 2008). Në vitin 2000, thatësira mesatare dhe të mëdha prekën pjesën më të madhe të territorit të Kosovës. Tetëdhjetë për qind (80 % e komunave të Kosovës kanë vuajtur nga mungesa e ujit që nga viti 2004, për shkak të mungesës së sistemeve efikase për menaxhimin e ujit.

Pujet përbëjnë 43% të territorit të Kosovës. Ato janë veçanërisht të ndjeshme ndaj zjarrit pyjor gjatë sezonit të thatë ose të verës. Që nga viti 2000 ka pasur një numër në rritje të zjarreve në pyje. Brigadat e zjarrit dhe ekipet e tjera operative kanë kryer 2,000 deri në 3,000 intervenime gjatë një viti. Parashihet që ekspozimi ndaj rreziqeve të tilla, si thatësira, vërshimet dhe zjarri do të rriten me ndryshimin klimatik dhe ngjarjet ekstreme të klimës.

Kosova ka një kornizë të pasur ligjore dhe institucionale për menaxhimin e fatkeqësive natyrore. Disa politika dhe rregullore kryesore janë: Ligji nr. 04 / L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera; Ligji nr. 04 / L-049 për luftimin dhe shpëtimin nga zjarri; Ligji nr. 04 / L-012 për mbrojtje nga zjarri;

Ligji nr. 04 / L-012 për mbrojtje nga zjarri; Rregullorja për metodologjinë e përgatitjes së vlerësimit të rrezikut; Rregullorja për Strukturën Organizative të Zjarrfikjes Profesionale dhe shpëtimin; Rregullorja për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të Planit të reagimit ndaj emergjencave; Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e sistemit të monitorimit, njoftimit dhe paralajmërimit; Udhëzimi administrativ për mbikëqyrjen e inspektimit për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri; Udhëzimi Administrativ mbi uniformën dhe simbolet e zjarrfikjes profesionale dhe njësitë e shpëtimin të zjarrit; dhe Udhëzimi Administrativ për organizimin dhe strukturimin e Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave.

Kosova ka gjithashtu një Plan Reagimi ndaj Emergjencave, cili është përgatitur në vitin 2010. Qëllimi kryesor i këtij plani është të krijojë një qasje gjithëpërfshirëse kombëtare në drejtim të menaxhimit të incidenteve ndaj të gjitha rreziqeve në spektrin e plotë të aktiviteteve që lidhen me parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe rikuperimin. Ky plan përcakton kapacitetet dhe burimet dhe cakton përgjegjësitë, proceset operative dhe protokollat për të ndihmuar mbrojtjen e vendit nga rreziqet natyrore dhe teknologjike dhe faktorët e nxitur nga njerëzit, kërkimi dhe shpëtimi, mbrojtja e shëndetit publik, siguria, mallrat dhe mjedisi.

Vetëqeverisja Lokale (Ligji Nr. 03/L-040) përcakton bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Ky ligj përcakton statusin ligjor të komunave, kompetencat e tyre dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, organizimet ndër-komunale dhe bashkëpunimin ndër-komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet në mes të komunave dhe qeverisë qendrore.

Është e qartë nga intervistat dhe nga një analizë e politikave dhe ligjeve përkatëse për Reagimin, Menaxhimin dhe Zvogëlimin e Fatkeqësive në Kosovë se ndikimi i rreziqeve natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu është marrë seriozisht nga Qeveria. Në përgjithësi, ekziston një kornizë e politikave, e përgatitur mirë, për reagimin ndaj fatkeqësive, si dhe ekziston një organ relativisht i rëndësishëm që mbështet legjislacionin. Megjithatë, boshllëqet kryesore mbeten në zbatimin e këtyre ligjeve dhe politikave, si dhe në krijimin e strukturave dhe kapaciteteve të nevojshme institucionale për të promovuar qëndrueshmërinë dhe vogëlimin e rrezikut. Arsyet për këto boshllëqe janë të shumëllojshme. Ky raport identifikon boshllëqet e ndryshme në politika dhe sugjeron strategjitë për fuqizimin e qëndrueshmërisë në nivel të politikave dhe atë komunal, për ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve të ndryshme të ndërlidhura për ZRRF-në dhe përmirësimin e koordinimit ndër-ministror ose ndër-departamente për të ofruar shërbime në të gjitha fazat e menaxhimit të fatkeqësive.

2. Historiku

Ky studim u sponsorizua nga “Save the Children Kosovë” për të shqyrtuar kornizën ligjore dhe të politikave për Menaxhimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (MRRF) dhe kornizën e politikave në Kosovë për të shpjeguar rolet dhe përgjegjësitë nëpër departamente të ndryshme kombëtare dhe komunale për zvogëlimin efektiv të rrezikut nga fatkeqësitë. Për ta realizuar këtë studim, u mbajtën intervista me informatorët kryesorë [IIK] dhe konsultime të strukturuar formale me palët kryesore të interesit në nivel kombëtar dhe komunal, bashkë me rishikimin e të dhënave sekondare. Shqyrtimi i të dhënave sekondare përfundoi në gusht të vitit 2015.

Përgatitja për hulumtimin në terren filloi në shtator 2015, me një mision 1 javor në terren nëpër Kosovë, nga 17 deri 23 shtator 2015. Duke pasur parasysh fushëveprimin relativisht të kufizuar të hulumtimit, ky studim nuk përpiqet të jetë një studim gjithëpërfshirës për të gjitha kornizat ligjore dhe institucionale relevante për MRRF-në në Kosovë. Në të kundërtën, ky raport ka për qëllim të ofrojë një përmbledhje dhe analizë të kornizës ligjore për MRRF-në në Kosovë, duke nxjerrë shembuj specifike të praktikave të mira si dhe duke identifikuar boshllëqet dhe sfidat kryesore në legjislacion dhe në zbatimin e tij.

3. Objektivat dhe metodologjia

Objektiva kryesore e këtij studimi ishte që të bëhet një rishikim dhe analizim i legjislacionit dhe politikave ekzistuese e cila synon të qartësojë rolet dhe përgjegjësitë e departamenteve të ndryshme në ZRRF në nivel komunal dhe të prodhojë një version të ndërlidhur të legjislacionit që ka të bëjë me ZRRF-në, për të qartësuar këto role dhe përgjegjësitë në nivel komunal.

Konsulenti/këshilltari i projektit, me ekipin e SCI në Kosovë u takua me zyrtarë të qeverisë dhe palë interesi kombëtare, komunale dhe të tjerë, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e Kombeve të Bashkuara dhe institucionet akademike (detajet janë dhënë në Shtojcën B). KII u mbajtën në bazë të Termave të Referencës (shih Shtojcën A). Këto intervista u fokusuan në kornizën ligjore për ZRRF në Kosovë dhe në zbatimin e saj, rolet e departamenteve dhe institucioneve të ndryshme, rreziqet aktuale nga fatkeqësitë dhe praktikrat e ZRRF-së, me vëmendje të veçantë për çdo praktikë të mirë dhe boshllëqet në nivel komunal, departamenti dhe në nivel qendror. Këto intervista ishin thelbësore për të fituar qasje në kopjet e ligjeve, të politikave dhe të dokumenteve të tjera, të cilat nuk ishin në dispozicion të publikut për qëllimet e studimit dhe analizës, dhe me njohuri për marrëveshjet institucionale për zbatimin e MRRF-së dhe aktivitetet për MRRF.

Për qëllime të studimit janë zgjedhur dy komuna, Mitrovica dhe Gjlani, përveç vizitave në zyrat qendrore të ministrive në qendër. Këto rajone u zgjodhën, sepse SCI Kosovë aktualisht është e angazhuar në mbështetjen e arsimit dhe të aktiviteteve për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në këto dy komuna, duke përfshirë arsimin gjithëpërfshirës dhe ndërtimin e shkollave. Përveç kësaj, këto rajone vuajnë nga vërshimet e përsëritura dhe kanë qenë të prekura edhe nga tërmeti në vitin 2010, që nënkupton se zyrtarët ishin në gjendje të merrnin përvojën e madhe në trajtimin/menaxhimin e fatkeqësive.

4. Profili i Rrezikshmërisë në Kosovë

Rishikimi i të dhënave dytësore ka treguar se Kosova është e ekspozuar ndaj të dy fatkeqësive, asaj hidrometeorologjike dhe asaj gjeologjike (vërshimet, reshjet e mëdha, thatësira, zjarri pyjor dhe tërmeti). Vërshimet e papritura janë të zakonshme në zonat malore (ku reshjet mesatare vjetore janë deri në 1,750 mm në vit), gjë që rezulton në rrëshqitje në disa zona. Kosova gjithashtu është e ekspozuar ndaj rrëshqitjeve të dheut, veçanërisht në zonën e Mitrovicës, Prishtinës, Pejës dhe Shtërpcës. Të paktën një e katërta e komuniteteve janë të ndjeshme ndaj rrëshqitjeve të dheut me një probabilitet prej 1% (10% mbi 10 vjet). Ndërsa fushat janë të prekura nga vërshimet e lumenjve; shpërthimi i reve është një fenomen tjetër që kërcënon Prishtinën, Mitrovicën, Besianën dhe Gjakovën, për shkak të ndjeshmërisë strukturore të pendave. Në disa pellgje të lumenjve të ekspozuar shumë (si Drini, në gjysmën perëndimore të vendit) vërshimet ndodhin çdo 2-3 vjet.

Qyteti i Ferizajt, në vitin 1973, është përballur me një përmbytje të rëndë që preku pjesën jugore të qytetit. Midis nëntorit 2007 dhe qershorit 2008, tre vërshime zhvendosën 3,500 persona dhe shkaktuan dëme në shtëpitë dhe tokën bujqësore, gjë që e bëri të nevojshme ndihmën humanitare nga bashkësia ndërkombëtare.

Për shkak të luhatjeve sezonale në reshje, prodhimi bujqësor në rajonet pa sistem të ujitjes alternative preket rëndë. Pamjaftueshmëria e ujit kryesisht prek zonat e ulëta të rrafshta në pjesën qendrore dhe lindore të vendit. Kjo ndodh për shkak të sezonalitetit të rrjedhave natyrore të lumenjve dhe rimbushjes së ujërave nëntokësore, si dhe për shkak të menaxhimit të dobët të ujit. Kosova është goditur disa herë nga thatësira në dy dekadat e fundit (1993, 2000, 2007 dhe 2008).

Në vitin 2000, ka ndodhur thatësira mesatare deri te ajo e madhe, e cila ka prekur pjesën më të madhe të territorit të Kosovës. Tetëdhjetë për qind (80%) e komunave të Kosovës kanë vuajtur nga mungesa e ujit që nga viti 2004, për shkak të mungesës së sistemeve efikase për menaxhimin e ujit.

Pyjët përbëjnë 43% të territorit të Kosovës. Ato janë veçanërisht të prirura ndaj zjarrit gjatë sezonit të thatë ose të verës. Që nga viti 2000 ka pasur një numër në rritje të zjarreve në pyje. Brigada zjarrfikëse dhe ekipet e tjera operative kanë kryer midis 2000 dhe 3000 intervenime për çdo vit pasues. Parashihet që ekspozimi ndaj rreziqeve të tilla, si thatësira, vërshimet dhe zjarret do të bëhen edhe më të mëdha me ndryshimet klimatike.

Ndryshueshmëria e klimës është rritur tashmë në Ballkanin Perëndimor. Disa dekadat e kaluara kanë dëshmuar rritjen e intensitetit të ekstremeve të reshjeve, si ngjarjet e shirave të rënda, si dhe thatësitat më të rënda, veçanërisht që nga vitet 1980. Ndryshimi i klimës për shkak të ngrohjes globale pritet që ta përshpejtojë këtë trend edhe më shumë. Sipas parashikimeve aktuale, temperaturat më të larta do të bëjnë që valët e nxehtësisë dhe zjarret në pyje të ndodhin më shumë. Ngjarjet ekstreme të reshjeve dhe ndryshueshmëria në rritje e rrjedhave të lumenjve do të

bëjnë që vërshimet të jenë më të shpeshta dhe më të rënda. Rritja e temperaturave, reshjet më të ndryshueshme dhe zvogëlimi i rrjedhjeve do të rrisin ekspozimin ndaj thatësisë Kosova ndodhet në një zonë sizmike aktive, duke e bërë atë më të ndjeshme ndaj tërmeteve. Tërmeti i fundit më i madh në Kosovë ka ndodhur në vitin 2010, në pjesën lindore të vendit dhe ka shënuar magnitudë 5.2 sipas Institutit Sizmologjik në Prishtinë. Kosova ka pësuar nivele të rënda shkatërrimi në disa raste për shkak të tërmeteve që kanë ndodhur në vendet fqinje, si Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni dhe Serbi.

Kosova: Përmbledhje e të dhënave mbi fatkeqësitë e shkaktuara nga rreziqet natyrore (1980- 2010), përfshirë këtu numrin e rasteve ku janë prekur njerëzit dhe ndikimin ekonomik (sipas Serbisë dhe Malit të Zi, meqë për Kosovë nuk ka të dhëna në dispozicion).

Fatkeqësia	Numri i ngjarjeve	Numri i ngjarjeve	Gjithsej vdekjet	Gjithsej të prekur
Tërmeti	1	0.25	1	100
Epidemia	2	12.50	0	869
Temperatura ekstreme	2	12.30	6	70
Vërshimet	9	56.25	14	125,398
Zjarri	1	6.25	0	12
Erërat e forta	1	6.25	0	0
Gjithsej	16	100	21	126,449

Raporti nga: UNICEF dhe UNISDR, dhjetor 2011- Fëmijët dhe Fatkeqësitë – Ndërtimi i qëndrueshmërisë përmes arsimit

5. Të gjeturat

Organizimi ligjor për Menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë:

Sipas Kushtetutës së Kosovës, ligjet e aprovuara lidhur me menaxhimin e emergjencave përfshijnë:

a) Ligjet mbi Menaxhimin e Emergjencave

<p>1. Ligji nr. 04/L-027 – Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera</p>	<p>Ky ligj përbëhet prej 15 kapitujsh dhe përfshin gjithsej 122 nene. Kapitulli mbulon një sërë aktivitetesh për arritjen e qëllimit të përgjithshëm të mbrojtjes së qytetarëve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Sipas këtij ligji janë përkrahur dispozitat e përgjithshme, programimi dhe planifikimi, struktura e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, arsimit, trajnimit dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare etj.</p>
<p>2. Ligji nr. 04/L-049 – Zjarrfikje dhe shpëtim</p>	<p>Ky ligj përbëhet prej 8 kapitujsh, duke përfshirë 26 nene. Kapitulli mbulon aktivitetet, rolet dhe përgjegjësitë e Ministrisë, Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, Komunat dhe njësitë e zjarrfikjes dhe shpëtimit sipas ligjit. Kapitujt si Dispozitat e Përgjithshme, Mbikëqyrja e njësisë zjarrfikëse dhe shpëtuese dhe menaxhimi i intervenimeve të zjarrfikësve; financimi, etj. shpjegojnë aspekte të ndryshme të ligjit.</p>
<p>3. Ligji nr. 04/L-012 – Mbrojtja nga zjarri</p>	<p>Ky ligj përmban 8 kapituj që kanë 41 nene. Sipas këtij ligji, masat për mbrojtjen nga zjarri, mbikëqyrja e zbatimit të masave për mbrojtje nga zjarri, trajnimit dhe kualifikimi profesional, dëshmia për gjendje të rregullt të pajisjeve, mirëmbajtja e pajisjeve dhe mjeteve, proceset teknologjike në mjedise të veçanta dhe përgjegjësitë e ministrisë, komunave dhe agjencive për menaxhimin e emergjencave janë përkrahur qartë.</p>

b) Rregulloret që kanë të bëjnë me sistemin për menaxhimin e emergjencave diskutohen si në vijim:

<p>1. Rregullorja për metodologjinë për zhvillimin e vlerësimit mbi rreziqet</p>	<p>Ekzistojnë 18 nene për zhvillimin e vlerësimit për rrezikun. Me anë të kësaj rregulloreje janë shprehur metodologjia për hartimin e vlerësimit të rrezikut ndaj popullsisë, materiali i infrastrukturës së rëndësishme dhe mallrat kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Shpjegohen edhe palët e interesit dhe pjesëmarrësit në hartimin e vlerësimit, si dhe procedurat për hartimin dhe aprovimin e atij vlerësimi.</p>
<p>2. Rregullorja për strukturën organizative të zjarrfikjes profesionale dhe shpëtimit</p>	<p>Në këtë rregullore janë 22 nene që përcaktojnë strukturën organizative të njësisë profesionale për zjarrfikje dhe shpëtim, si grupi i zjarrfikjes dhe shpëtimit, ekipi zjarrfikës dhe shpëtues, ekipi zjarrfikës dhe shpëtues, batalioni zjarrfikës dhe shpëtues dhe brigada e zjarrfikjes dhe shpëtimit. Nenet po ashtu përshkruajnë trajnimin dhe gatishmërinë e njësisë zjarrfikëse dhe pajisjeve teknike, si dhe kriteret kryesore për organizimin dhe funksionimin e tyre.</p>
<p>3. Rregullorja për përmbajtjen dhe procedurat për hartimin e planit për reagim ndaj emergjencave</p>	<p>Kjo rregullore përbëhet prej 30 nenesh që shpjegojnë se: planet do të hartohen në dokumentin “Vlerësimi i rrezikut” ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Planet duhet të përcaktojnë masat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Sipas këtyre neneve, planet duhet të mbulojnë edhe objektet ndërtimore në mënyrë që të shmangen nga ndikimi i fatkeqësive. Planet duhet të demonstrojnë rreziqet e mundshme, burimet, rolet dhe përgjegjësitë e qytetarëve dhe akterëve të tjerë kryesorë dhe institucionet etj. Rregullorja shpjegon procedurat e hartimit të planit emergjent më gjerësisht.</p>

<p>4. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e sistemit për monitorim, njoftim dhe paralajmërim</p>	<p>Kjo rregullore përcakton organizimin dhe funksionimin e një rrjeti monitorues të qendrës për informim dhe alarmim, e cila përbëhet nga sistemi për monitorim, njoftim dhe paralajmërim të Republikës së Kosovës. Nenet mbulojnë monitorimin, rrjetin dhe raportimin e të dhënave, raportet e ministrive, institucioneve dhe organizatave të tjera. Janë shpjeguar rolet e qendrave të informimit, qendrat e operimeve, detyrat e qendrave operacionale, detyrat e qendrave të thirrjes 112, qendrat lokale të emergjencës. Këtu përfshihen po ashtu sistemi i lajmërimit publik, shenjat alarmuese, përdorimi dhe kuptimi i shenjave alarmuese dhe informimi i qytetarëve për shenjat alarmuese.</p>
---	---

c) Udhëzimet administrative lidhur me Menaxhimin e emergjencave përfshijnë:

<p>1. Udhëzimi administrativ për hetimin, mbikëqyrjen e zbatimit të masave për mbrojtje nga zjarri</p>	<p>Janë shpjeguar 14 nene për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është të rregullojë modelin e ushtrimit të mënyrës së mbikëqyrjes inspektuese për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri, si dhe përcaktimi i procedurave unike të veprimit të organit të Ministrisë së Punëve të Brendshme - janë përshkruar Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. Llojet e kontrolleve të inspektimit për zjarr, d.m.th. kontrolli bazë i inspektimit, kontrolli i rregullt i inspektimit, verifikimi i kontrollit të inspektimit dhe kontrolli i zakonshëm shesë i inspektimit.</p>
--	---

<p>2. Udhëzimi administrativ për uniformën dhe simbolet e njësive për zjarrfikje profesionale dhe shpëtim</p>	<p>Njëzet e katër nenet e këtij udhëzimi përcaktojnë llojin, modelin dhe përbërjen e uniformës së punës dhe uniformën solemne, veshjes shtesë, kohëzgjatjes së përdorimit të tyre, simbolet dhe emërtimet dhe shenjat e funksioneve të anëtarëve të njësisë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit në Republikën e Kosovës.</p>
<p>3. Udhëzimi administrativ për organizimin dhe strukturën e agjencisë për menaxhimin e emergjencave</p>	<p>Katërmëdhjetë nenet në këtë udhëzim kanë të bëjnë me misionin dhe fushëveprimin e Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, Buxhetin, Strukturën e Agjencisë, d.m.th. Departamentin e Parandalimit, Departamentin e Përgatitjes, Departamentin e Operimeve, Departamentin e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, të cilat janë shpjeguar me rolet dhe përgjegjësitë e tyre.</p>

d) Plani për Reagim Emergjent (2010)

Objektiva kryesore e këtij plani është të krijojë një qasje gjithëpërfshirëse kombëtare për menaxhimin e incidenteve ndaj të gjitha rreziqeve në spektrin e plotë të aktiviteteve që kanë të bëjnë me parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe rimëkëmbjen. Ai përfshin përvojat dhe procedurat më të mira nga disiplina të ndryshme të menaxhimit të incidenteve (siguria kombëtare, menaxhimi i emergjencave, zbatimi i ligjit, zjarrfikja, reagimi ndaj substancave të rrezikshme, punët publike, shëndeti publik, shërbimet emergjente mjekësore dhe punëtorët për reagim dhe rimëkëmbje, në fushën e shëndetit dhe të sigurisë) dhe i integron ato në një strukturë të koordinuar dhe të përbashkët. Plani Kombëtar për Reagim ofron një kornizë për ndërveprim qendror me qeverisjen lokale dhe strukturat e degëve rajonale, sektorin privat dhe OJQ-të në kontekst të aktiviteteve për parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe rimëkëmbjen nga incidentet/emergjencat/fatkeqësitë. Ky plan përcakton kapacitetet dhe burimet dhe cakton përgjegjësitë, proceset operative dhe protokollet për të ndihmuar dhe për të mbrojtur vendin nga rreziqet natyrore dhe teknologjike dhe nga faktorët e nxitur nga njerëzit, kërkimi dhe shpëtimi, mbrojtja e shëndetit publik, siguria, mallrat dhe mjedisi. Në fund, Plani Kombëtar për Reagim shërben si bazë për zhvillimin e procedurave të detajuara shtesë për zbatimin e aktiviteteve më efektive dhe efikase për menaxhimin e incidenteve në kontekstin e llojeve të veçanta të incidenteve.

e) Sipas 04/L-027

Organizata kryesore në Kosovë që është përgjegjëse për Menaxhimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (MRRF) dhe potencialisht për ZRRF-në është Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Fushëveprimi i AME-së është që të mbështesë qytetarët dhe ekipet e para të reagimit për të siguruar veprim të përbashkët, në ndërtimin, ngritjen dhe mbajtjen e kapaciteteve të nevojshme për përgatitjen, mbrojtjen, reagimin dhe rimëkëmbjen nga të gjitha llojet e rreziqeve. Detyrat kryesore të AME-së përfshijnë:


- Hartimi dhe aprovimi i Sistemit të Integruar për Emergjencë;
- Hartimi dhe aprovimi i Planit Kombëtar të Reagimit;
- Përgatitja dhe trajnimi i shërbimeve emergjente;
- Koordinimi i vendeve të inspektimit me materiale të rrezikshme;
- Ristrukturimi i DME-së dhe përmirësimi i AME-së;
- Hartimi dhe aprovimi i vlerësimit të rrezikut dhe planeve operative për mbrojtje dhe shpëtim;
- Hartimi, plotësimi, ndryshimi i infrastrukturës ligjore dhe hartimi i ligjit;
- Menaxhimi dhe koordinimi i rasteve emergjente;
- Iniciativat e vërteta të bashkëpunimit me vendet e rajonit dhe vendet evropiane në fushën e emergjencës, duke përfshirë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit dhe draft-marrëveshjet.

f. Vetë-qeverisja lokale (Ligji Nr 03/L-040)

Ky ligj përcakton bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Kosovë dhe përcakton statusin ligjor të komunave, kompetencat e tyre dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, rregullimet brenda komunës dhe bashkëpunimi ndër-komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndër-kufitar dhe marrëdhëniet në mes të komunave dhe të qeverise qendrore. Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e cila përbëhet nga komuniteti i qytetarëve të një territori të caktuar, të përcaktuar me ligj, dhe e cila ushtron të gjitha kompetencat të cilat nuk janë rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore. Të gjitha autoritetet komunale i përgjigjen qytetarëve të komunës në format e përcaktuara me ligj. Qytetarët e komunës kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitetet e komunës, siç parashihet me ligj. Komunitat kanë të drejtë të bëjnë marrëveshje me fshatra, lagje ose vendbanime brenda territorit të tyre për të ofruar shërbime më afër qytetarëve, në përputhje me Nenin 35 dhe statutet e tyre. Komunitat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për aq sa kanë të bëjnë me interesin lokal, duke respektuar standardet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në fushat e mëposhtme:

- Zhvillimi ekonomik lokal;
- Planifikimi urban dhe rural;
- Përdorimi dhe zhvillimi i tokës;
- Zbatimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit
- Mbrojtja mjedisore lokale;
- Sigurimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike dhe komunale, duke përfshirë: furnizimin me ujë, kanalizimet dhe kullimet, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transportin lokal dhe skemat e ngrohjes lokale;
- Reagimi emergjent lokal;
- Sigurimi i arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, publik, duke përfshirë regjistrimin;
- Licencimi i institucioneve arsimore, rekrutimi, pagesa e pagave dhe trajnimi i instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut;
- Sigurimi i kujdesit shëndetësor parësor publik;
- Ofrimi i shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç janë kujdesi për grupet më të cenueshme, përkujdesja, kujdesi për fëmijët, kujdesi për të moshuarit, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të kujdesit, rekrutimi, turizmi etj.

f) Roli i palëve të interesit në procesin e politikëbërjes për menaxhimin e reagimit emergjent të Kosovës



OJQ-të | Agjencitë e OKB-së | Kompanitë | Autoritetet/komunitetet lokale | Organizatat vullnetare

6. Analiza dhe përfundimet

Intervistat dhe një analizë e politikës dhe ligjit që ka të bëjë me Reagimin, Menaxhimin dhe Zvogëlimin e Fatkeqësive në Kosovë ka zbuluar se ndikimi i rreziqeve natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu duhet të merret seriozisht. Në përgjithësi, ekziston një kornizë për politika, e zhvilluar mirë, lidhur me Reagimin ndaj Fatkeqësive në Kosovë, si dhe një organ mjaft i rëndësishëm i legjislacionit mbështetës. Megjithatë, boshllëqet kryesore mbeten në zbatimin e këtyre ligjeve dhe politikave, si dhe në krijimin e strukturave dhe kapaciteteve të nevojshme institucionale për të promovuar qëndrueshmërinë dhe zvogëlimin e rrezikut. Arsyet për këto boshllëqe janë të shumëllojshme, por është e mundur që të nxirren disa përfundime paraprake, në bazë të hulumtimeve dhe intervistat e kryera gjatë këtij studimi.

Sistemi Institucional dhe Ligjor për Menaxhimin e Fatkeqësive

Edhe pse ligjet për menaxhimin e emergjencave, të shpjeguara në seksionin 4, tregojnë rolet dhe përgjegjësitë e secilës ministri dhe secilit departament, rolet dhe përgjegjësitë e caktuara të organizatave nuk janë të përcaktuara qartë dhe kufizohen vetëm në aktivitetet e reagimit emergjent. Ekziston nevoja për të krijuar një strukturë institucionale gjithëpërfshirëse për menaxhimin e fatkeqësive, duke përfshirë nivelet kombëtare dhe komunale. Secila organizatë qeveritare duhet të dijë rolet dhe përgjegjësitë e saj, si dhe detyrat specifike për të gjitha fazat e fatkeqësisë, para, gjatë dhe pas fatkeqësisë. Për më tepër, rolet dhe përpjekjet që duhen ndërmarrë nga shoqëria civile, komuniteti dhe individët duhet të përcaktohen qartë në mënyrë që të zvogëlohet rreziku nga fatkeqësitë. Qeveria duhet të promovojë dhe të mbështesë aktivitetet e tyre. Organizatat qeveritare përkatëse në menaxhimin e fatkeqësive duhet të përgatiten për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, reagimet emergjente dhe rehabilitimin dhe planet e rindërtimit. Planet e tilla duhet të marrin parasysh kapacitetin ekzistues të burimeve njerëzore dhe të propozojnë masa për të rritur kapacitetin e organizatave dhe të komunitetit. AME duhet të jetë në gjendje që të ofrojë udhëzime teknike dhe bashkërendim në mes të organizatave për menaxhimin e fatkeqësive, duke mbajtur takime dhe punëtori herë pas here. Pas formulimit të planit për menaxhimin e fatkeqësive për secilën organizatë, duhet të mbahen trajnime në bazë të këtyre planeve. Rezultatet e ushtrimeve dhe të trajnimit do të pasqyrohen në përmirësimin e planeve për menaxhimin e fatkeqësive, me qëllim që të sigurohet një funksionim efikas dhe efektiv i këtyre planeve. Në të njëjtën kohë, duhet të përmirësohet kapaciteti i organizatave dhe personelit në nivel komunal për institucionalizimin e ZRRF-së.

Planet për Menaxhimin e Fatkeqësive në Nivele të Ndryshme

Zvogëlimi i rreziqeve nga fatkeqësitë përfshin masa të ndryshme, si ndërtimi më i sigurt i infrastrukturës, ripërshtatja e ndërtesave, largimi i ujërave nga shiu, zhvendosja e banesave dhe shkollave nga zonat e rrezikuara, trajnimi, ngritja e vetëdijesimit, ofrimi i

burimeve më të sigurta të jetesës etj. Masat përgatitore për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë përfshijnë zhvillimin e sistemeve paralajmëruese dhe planeve për evakuim dhe masave të tjera parandaluese që duhet të merren në periudhën para fatkeqësisë. Ato gjithashtu përfshijnë edukimin dhe trajnimin e zyrtarëve, ekipeve dhe komuniteteve në kërkim dhe shpëtim, zjarrfikje, evakuim, menaxhim të aksidenteve masive etj. Zhvillimi i politikave, rregulloreve dhe planeve operative që do të aplikoheshin pas një katastrofe është po ashtu vendimtare. Planet efektive duhet të marrin parasysh dhe të identifikojnë sigurimin e burimeve; p.sh., grumbullimin e furnizimeve dhe caktimin e fondeve. Gjatë hulumtimit ose IKK-ve, planet për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë nuk kanë mundur të gjenden në nivel kombëtar dhe komunal. Megjithatë, planet e reagimit emergjent janë përgatitur nga shkollat dhe komunat, por nuk janë përditësuar për çdo vit. Planet e ZRRF-së janë qenësore për zvogëlimin e rrezikut në nivel lokal dhe komunal. Planet për menaxhimin e fatkeqësive në nivel komunal duhet të përgatiten nga këshilli komunal, në bashkëpunim me komisionet e komuniteteve, drejtoritë, departamentet përkatëse, OSHC-të dhe Drejtoria e Menaxhimit të Emergjencave. Planet duhet të përfshijnë identifikimin e zonave në rrezik nga fatkeqësitë në nivel komunal, vendet dhe rrugët e evakuimit, reagimet e nevojshme dhe aktivitetet e përgatitjes etj. Gjithashtu, është e rëndësishme që të përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë e palëve të interesit dhe të fuqizohet bashkërendimi ndërmjet agjencive përkatëse në nivel komunal përmes Planifikimit të MRRF-së. Në këtë mënyrë, është e nevojshme që të përgatiten planet sektoriale për menaxhimin e fatkeqësive në ministritë qendrore, departamentet dhe autoritetet.

Sistemet për paralajmërim të Hershëm dhe Evakuim nga rreziqet e shumta

Një sistem i paralajmërimit të hershëm nga rreziqet e shumta (SPH) është një mekanizëm për sigurimin e paralajmërimit të hershëm në mënyrë që t'u mundësohet vendimmarrësve dhe komuniteteve që të ndërmarrin veprimet e duhura para shfaqjes së një rreziku. Një sistem efektiv i paralajmërimit të hershëm përfshin kapacitetet teknike për monitorimin e rreziqeve dhe analizën e të dhënave dhe një mekanizëm për sistemet e vendimmarrjes dhe të komunikimit, për të shpërndarë mesazhe paralajmëruese tek komunitetet. Një SPH nga rreziqet e shumta është jetike për zvogëlimin e rreziqeve dhe humbjeve nga fatkeqësitë në Kosovë. Një sistem i paralajmërimit të hershëm nga rreziqet e shumta (SPH) është një mjet i rëndësishëm për të dalë nga cikli vicioz dhe është bërë një çështje e rëndësishme në Kosovë. Megjithatë, deri më tani, përpjekjet teknike për të zhvilluar një SPH nga rreziqet e shumta nuk është krijuar në mënyrë efektive, për shkak të bashkëpunimit jo të mjaftueshëm në mes të agjencive përkatëse. Disa sektorë të ndryshëm janë angazhuar në prodhimin e informatave SPH të cilësisë së lartë, megjithatë, institucione të ndryshme pa përcaktim të qartë të përgjegjësive kryejnë veprimtari të shqyrtimit dhe shpërndarjes.

Gjithashtu, nuk ekziston një kornizë e qartë për shpërndarjen e paralajmërimeve të hershme sidomos në nivel lokal dhe mungon integrimi i SPH tradicionale në sistemin formal. Gjithashtu është e nevojshme të rritet dhe të fuqizohet kapaciteti teknik i

SPH-së, veçanërisht në sistemet e parashikimit të motit për zbutjen e rreziqeve nga fatkeqësitë. Për më tepër, komunitetet nuk janë të vetëdijshme për SPH-në dhe nuk kanë njohuri për masat për parandalimin e fatkeqësive. Në këtë kontekst, duhet të përgatiten hartat e rreziqeve dhe fatkeqësive në nivel lokal për zonat e cenueshme veçanërisht ndaj vërshimeve të shpejta dhe rrëshqitjeve të tokës, fatkeqësitë e lokalizuara më përkatëse lidhur me sistemin e paralajmërimit të hershëm. Përpjekja për të zhvilluar një SPH nga rreziqet e shumta duhet të realizohet me përfshirjen e një numri të palëve të interesit, në mënyrë që funksionimet efektive të SPH-së të sjellin përfitime të shumta. Komunikimi i besueshëm, efikas dhe efektiv dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm nga rreziqet e shumta janë kyçe për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Palët e interesit të mëdha që kanë të bëjnë me një SPH nga rreziqe të shumta janë:

Qeveria qendrore	AME, Departamenti meteorogjik, MFA, IEMS, MMPH, Ministrinë dhe Departamentete përkatëse.
Komunat	MC, DEM, Drejtorinë, MSSC, MDPR (Emergjencia), MDPS, Policia, jarrfikësit dhe Spitalet etj.
Të tjerët	OJQ-të, Shkollat, Media, Xhamitë, etj.

Trajnimi, edukimi dhe vetëdijesimi për menaxhimin e fatkeqësive

Qëllimi i trajnimit, edukimit dhe vetëdijesimit për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë (MRRF) është që të rrisë kapacitetin e ekspertëve në organizata përkatëse dhe publikun e gjerë për të kryer aktivitetet e menaxhimit të fatkeqësive në mënyrë efektive dhe efikase. Nuk ka ndonjë organizatë të veçantë që koordinon dhe udhëheq aktivitetet e zhvillimit të burimeve njerëzore në fushën e menaxhimit të fatkeqësive në Kosovë, siç është shpjeguar më sipër. Zhvillimi i burimeve njerëzore në fushën e menaxhimit të fatkeqësive përfshin një mori aktivitetesh, përfshirë këtu trajnimin për kërkimi dhe shpëtim dhe hulumtimin teknik për menaxhimin e fatkeqësive. Këto aktivitete janë kryer nga organizata të ndryshme. Për të menaxhuar një numër të aktiviteteve në zhvillimin e burimeve njerëzore, AME dhe Drejtoria e EM-së në nivel komunal duhet të luajnë një rol udhëheqës në aktivitetet për zhvillimin e burimeve njerëzore në fushën e menaxhimit të fatkeqësive. Duke marrë parasysh burimet e kufizuara, zhvillimi i burimeve njerëzore kërkon që grupet e synuara të rrisin kapacitetet e tyre në menaxhimin e fatkeqësive. Për ta bërë shoqërinë të qëndrueshme ndaj dëmtimit nga fatkeqësitë, zhvillimi i burimeve njerëzore duhet të fillojë me fuqizimin e kapacitetit të publikut të gjerë, të komuniteteve dhe agjencive qeveritare. Këto grupe të synuara duhet të jenë

të vetëdijshme për dijeni për zbutjen e fatkeqësive dhe masat përgatitore, në mënyrë që të fillojnë të ndërmarrin veprime për të zbutur dëmet e ardhshme nga fatkeqësitë. Pak organizata e kuptojnë se zhvillimi i burimeve njerëzore në fushën e menaxhimit të fatkeqësive është detyrë e tyre. Meqenëse ekziston një numër i madh objektivash, zhvillimi i burimeve njerëzore duhet të bëhet nga shumë organizata me bashkëpunim të ndërsjellë.

Organizatat kryesore që do të jenë përgjegjëse për zhvillimin e burimeve njerëzore janë paraqitur në tabelën në vijim. AME duhet të marrë iniciativën në zbatimin e aktiviteteve për zhvillimin e burimeve njerëzore në organizata të ndryshme. Përvojat e kaluara dhe rezultatet e hulumtimit në fushën e menaxhimit të fatkeqësive nuk janë grumbulluar mirë në Kosovë. Një bazë të dhënash me shënime të vjetra për rreziqet nuk është plotësisht në dispozicion dhe hulumtimi në fushën e menaxhimit të fatkeqësive nuk është bërë në mënyrë efektive edhe pse Kosova ka përjetuar shumë fatkeqësi. Është e nevojshme që të rritet njohuria dhe teknologjia në fushën e menaxhimit të fatkeqësive. Për këtë qëllim kërkohet krijimi i një Qendre hulumtuese në fushën e menaxhimit të fatkeqësive.

Palët kryesore të interesit lidhur me trajnimin, edukimin dhe rritjen e vetëdijesimit janë:

Qeveria qendrore	AME, IEMS, MMPH, Ministrinë përkatëse dhe Departamentet.
Komunat	MC, DEM, Drejtoritë, MSSC, MDPR (Emergjencia), Policia, Zjarrfikësit dhe Spitalet etj.
Të tjera	KRC, OJQ-të, Shkolla, Media, Xhamitë etj.

Fuqizimi i programit për vetëdijesim për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë në nivel lokal

Komunitetet lokale, infrastruktura lokale dhe ekonomia lokale janë të prekura drejtpërdrejt nga fatkeqësitë. Një “Program për Zvogëlimin e Rrezikut në Nivel Lokal dhe në Komunitet” është thelbi i zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Komunitetet lokale dhe komunat janë lojtarët e parë që reagojnë ndaj çdo fatkeqësie. Duke pasur parasysh këtë karakteristikë të situatës së fatkeqësisë, është e rëndësishme që programet për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë të zbatohen për vetëdijesim dhe zhvillim të kapaciteteve në nivel lokal, duke përfshirë zyrtarët qeveritarë vendorë, komunitetet dhe organizatat e shoqërisë civile. Shfrytëzimi efektiv i burimeve lokale është thelbësor në të gjitha fazat e menaxhimit të fatkeqësive, d.m.th. përgatitja, reagimi, rimëkëmbja dhe rindërtimi. Përveç kësaj, planet për menaxhimin e fatkeqësive në nivel lokal në fshatra, nivele komunale, janë të rëndësishme në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Nga numri i intervistave dhe rishikimi i të dhënave sekondare janë identifikuar çështjet e mëposhtme në lidhje me aktivitetet e MRRFBK-së dhe programet për vetëdijesimin e publikut në përgjithësi. Në zonat që kanë pasur shpesh fatkeqësi, perceptimet e qytetarëve për rrezikun janë relativisht të larta. Megjithatë, njohja e fatkeqësive dhe kundërveprimeve ndaj tyre nuk është e mjaftueshme.

Qytetarët nuk janë të vetëdijshëm për faktin se menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë kërkon përpjekje të përbashkëta për “vetë-ndihmë, ndihmë reciproke dhe ndihmë publike”. Shumica e qytetarëve presin ndihmën publike në radhë të parë, por ata nuk janë të vetëdijshëm se çfarë mund të bëjnë ata ose komunitetet fqinje për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Organizata të ndryshme, kryesisht KKK dhe agjencitë e OKB-së, kanë zhvilluar aktivitete për Përgatitjen për Fatkeqësi me bazë në Komunitet dhe kanë përgatitur module dhe materiale trajnimi. Aktivitetet e MRRFBK-së shpesh janë të kufizuara në reagimin emergjent dhe në gatishmëri. Disa komunitete dhe komuna kanë përgatitur skema zhvillimi, por shfrytëzimi i këtyre skemave për masat lehtësuese në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë ende nuk është vënë në praktikë. Disa shkolla kanë përgatitur plane sigurie, por përditësimi i këtyre planeve për çdo vit nuk është në praktikë apo madje orientimi i nxënësve në mënyrë të rregullt. Shumë qeveri lokale ende nuk i kanë caktuar vendet e sigurta për evakuim për qytetarët. Në disa raste, edhe pse janë identifikuar vende të sigurta për evakuim, ato ndodhen shumë larg komuniteteve.

Korniza gjithëpërfshirëse për sigurinë në shkolla (KGJSSH)

Fatkeqësitë si, tërmetet, vërshimet, erërat ekstreme, rrëshqitjet e dheut dhe zjarri kërcënojnë jetën e fëmijëve dhe të personelit në shkolla, mbrojtjen dhe ribashkimin e fëmijëve me familjet e tyre, të drejtat e fëmijëve në arsim dhe investimin afatgjatë në infrastrukturën e arsimit. Fatkeqësitë kanë ndikime të madh në shkolla. Ato përfshijnë: ndikimet fizike tek nxënësit dhe personeli - pasojat më tragjike janë kur vriten nxënësit dhe personeli në shkolla të pasigurta, të ndërtuara në mënyrë të dobët, në shkolla që nuk janë ndërtaur ashtu që t'i bëjnë ballë rreziqeve natyrore të pritura dhe të përsëritura, ose në rrugën për në shkollë; Ndikimet fizike në objekte shkollore - ky dëm në infrastrukturë - paraqet humbje të jashtëzakonshme të investimeve zhvillimore nga qeveria, donatorët dhe komuniteti - shkollat operationale janë të rëndësishme për vazhdimësinë e arsimit të nxënësve, për mundësinë e prindërve që të kthehen në punë dhe për rimëkëmbjen e komunitetit;

Ndikimet arsimore tek nxënësit - kur nuk ka plane për vende alternative dhe mekanizma për shpërndarje, vazhdimësia e arsimit pengohet dhe një numër i madh i nxënësve përjashtohen nga të drejtat për arsim që i kishin gëzuar më parë dhe të cilat ende i gëzojnë të tjerët; Ndikimet ekonomike prekin regjistrimin në shkollë - vonesat në regjistrim mund t'ua vështirësojnë familjeve për të mbështetur fëmijët që të vazhdojnë dhe ta përfundojnë arsimin e tyre; dhe ekzistojnë edhe ndikime psiko-sociale tek nxënësit dhe personeli - ku nuk është zhvilluar qëndrueshmëria

dhe ku komunitetet shkollore janë të përgatitura keq për të ofruar ndihmë të parë psikologjike, rimëkëmbja ngadalësohet. Të gjitha këto pasoja negative mund të shmangen me planifikimin sistematik dhe me zvogëlimin e rrezikut.

Sistemi ekzistues i MA mbështet plotësisht integrimin e ZRRF-së në nivel kombëtar dhe komunal. Nga diskutimet dhe takimet me departamentin e arsimit, ata janë të gatshëm që të institucionalizojnë ZRRF-në nga nivelet komunale në ato lokale, me mbështetjen teknike të partnerëve ndërkombëtarë, MOE dhe AME në sistemet e tyre arsimore ekzistuese, d.m.th. trajnimet e mësimitdhënësve, ndërtimi i shkollave të reja, strukturat e menaxhimit të shkollave, sistemi i paralajmërimit të hershëm, ZRRF-ja dhe planet zhvillimore të shkollave dhe këshilli studentor etj. Drejtoria në nivel komunal mund të akomodojë zvogëlimin e rrezikut në mekanizmat ekzistues për të promovuar kulturën e qëndrueshmërisë.

7. Strategjitë e propozuara

1. Sistemi institucional dhe ligjor për menaxhimin e fatkeqësive:

- Krijimi dhe funksionimi i organizatave për menaxhimin e fatkeqësive në nivel komunal, në nivel komuniteti dhe në atë të shkollës.
- Formulimi i planeve operacionale për menaxhimin e fatkeqësive në nivel kombëtar, komunal, të komunitetit dhe shkollës.
- Zbatimi i takimeve periodike në mesin e organizatave për menaxhimin e fatkeqësive për të monitoruar situatat në nivel komunal dhe kombëtar.
- Zbatimi i trajnimit dhe ushtrimeve për aktivitetet për menaxhimin e fatkeqësive në organizata për të përmirësuar kapacitetet e tyre.

2. Planet për menaxhimin e fatkeqësive në nivele të ndryshme:

- Formulimi dhe përditësimi i planeve për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në nivel kombëtar, komunal dhe në nivel komuniteti.
- Zhvillimi i planeve emergjente specifike për rrezikun.

3. Sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe të evakuimit të shumë rreziqeve:

- Fuqizimi i sistemeve të parashikimit dhe të paralajmërimit të hershëm.
- Përgatitja e hartave të rrezikshmërisë në shkallë lokale në komuna.
- Fuqizimi i sistemeve të shpërndarjes së paralajmërimit të hershëm.
- Zhvillimi i kapaciteteve të sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe të evakuimit.

4. Trajnimi, edukimi dhe vetëdijesimi në lidhje me menaxhimin e fatkeqësive:

- Fuqizimi i AME-së dhe DME-së në nivel kombëtar dhe komunal për të promovuar zhvillimin e burimeve njerëzore në fushën e menaxhimit të fatkeqësive.
- Rritja e kapacitetit të Këshillit komunal dhe të drejtorive përgjegjëse për menaxhimin e fatkeqësive në nivel komunal.
- Promovimi i integritit të ZRRF-së përmes rritjes së kapaciteteve të zyrtarëve qeveritarë.
- Zhvillimi i kapaciteteve të shkollave dhe komuniteteve për t'u përballur me fatkeqësitë.
- Ngritja e vetëdijes së njerëzve për menaxhimin e fatkeqësive.

5. Fuqizimi i programit për vetëdijesim lidhur me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në nivel lokal:

- Zgjerimi i njohurive të DM-së tek publiku i gjerë.
- Krijimi i vendeve të sigurta për evakuim në rastin e situatës së fatkeqësisë.
- Zbatimi dhe shpërndarja e aktiviteteve të MRRFBK-së.
- Përhapja e përpjekjeve të vetë-ndihmës dhe përpjekjeve për ndihmë reciproke në menaxhimin e fatkeqësive.
- Krijimi i masave DM të inkorporuara në programet zhvillimore ekzistuese.

6. Korniza gjithëpërfshirëse për sigurinë në shkolla (KGJSSH):

- Objekte të sigurta shkollore.
- Menaxhimi i fatkeqësive në shkolla.
- Edukimi për zvogëlimin e rrezikut.

8. Rolet dhe Përgjegjësitë e propozuara

1. Komuna

- Formulimi i planit komunal për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë, në bazë të vlerësimit të rrezikut lokal dhe koordinimit të zbatimit të tij;
- Rishikimi i planeve zhvillimore dhe ofrimi i udhëzimeve për integrimin e masave për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në këto plane;
- Monitorimi i vazhdueshëm i rreziqeve dhe kushteve të dobëta brenda komunës;
- Përgatitja e udhëzimeve dhe standardeve për palët e interesit lokale në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë;
- Realizimi i programeve të edukimit, trajnimit dhe vetëdijesimit publik për zyrtarët lokalë, palët e interesit dhe komunitetet;
- Inkurajimi i përfshirjes së grupeve të komunitetit në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe kundërpërgjigja duke u ofruar atyre ndihmë financiare dhe teknike të nevojshme për zbatimin e iniciativave në nivel komuniteti;
- Ekzaminimi i ndërtimit në zonë dhe nëse nuk janë ndjekur standardet e sigurisë nga rreziqet, adresimi tek entitetet përkatëse për të siguruar përputhjen me këto standarde;
- Investimi në aftësi specifike sipas kërkesës, për të menaxhuar të gjitha llojet e kërcënimeve sipas zonës përkatëse;
- Ndërmarrja e masave të duhura përgatitore në nivel komunal. Ushtrimi mund të përfshijë mirëmbajtjen e sistemit të paralajmërimit të hershëm, identifikimin e ndërtesave që do të përdoren si vende evakuimi, grumbullimin e materialeve për ndihmë dhe shpëtim dhe identifikimin e mjeteve alternative për komunikim emergjent;
- Promovimi dhe mbështetja e hulumtimit shkencor, zhvillimit të teknologjive të reja dhe përdorimit të njohurive lokale në masat që synojnë mbështetje në zvogëlimin e rrezikut;
- Të sigurohet që përvoja, njohuritë dhe burimet, rajonale dhe ndërkombëtare, janë në dispozicion për të mbështetur përpjekjet në zvogëlimin e rrezikut dhe menaxhimin e fatkeqësive.

Reagimi ndaj fatkeqësive

Kërkimi dhe shpëtimi: Prioriteti i parë pas një fatkeqësie është që të minimizohet humbja e jetës përmes përpjekjeve për të shpëtuar njerëzit e prekur dhe për të ofruar trajtim mjekësor. Njerëzit të cilët janë bllokuar në ndërtesat e shkatërruara ose janë të izoluar për shkak të përmytjeve kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme. Komuna në koordinim me autoritetet lokale do të jetë përgjegjëse për operacionet

e kërkimit dhe shpëtimit në një rajon të prekur. Duke vepruar kështu, ata do të ndjekin planet për menaxhimin të fatkeqësive dhe do të mbështeten nga departamentet qeveritare.

Strehimi, Shëndeti dhe Higjiena: Fatkeqësitë mund të prishin mekanizmat e ushqimit, furnizimit me ujë dhe të higjienës. Ato gjithashtu mund t'i detyrojnë njerëzit të braktisin shtëpitë e tyre, qoftë përkohësisht ose përgjithmonë. Situata të tilla zakonisht rezultojnë në një nevojë të menjëhershme për strehim dhe mbrojtje nga një incident epidemik. Komuna do të koordinojë ofrimin e shërbimeve të strehimit të përkohshëm, të shëndetësisë dhe të higjienës për viktimat e shpëtuar, në mënyrë që të parandalojë një shpërthim të sëmundjes.

Infrastruktura dhe Shërbimet Thelbësore: Fatkeqësitë mund të shkatërrojnë infrastrukturën, në kuptim të rrugëve, ndërtesave publike, aeroporteve dhe rrjetit të komunikimit. Një prioritet i menjëhershëm pas një katastrofe është që të sjellë infrastrukturën bazë në gjendje funksionale dhe të adresohen zjarret dhe kushtet e tjera të rrezikshme që mund të vazhdojnë edhe pas fatkeqësisë. Komuna do të punojë në koordinim të ngushtë me departamentet qeveritare për të rikthyer infrastrukturën në gjendje funksionale normale.

Siguria: Zakonisht, në një situatë fatkeqësie, policia dhe personeli i sigurisë janë të preokupuar me kryerjen e misioneve të kërkimit dhe shpëtimit. Disa njerëz mund të përfitojnë nga kjo situatë dhe të mbështeten në aktivitete antisociale. Komuna do të ishte e obliguar që të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar që agjencitë e sigurisë të asistohen në parandalimin e kësaj situatë, në mënyrë që të garantohet një ndjenjë sigurie për njerëzit.

Komunikimi: Komuna do t'i komunikojë komunitetit të gjerë ndikimin e fatkeqësisë dhe aktivitetet specifike që po ndërmerren ose që duhet të ndërmerren për të zvogëluar ndikimin e saj. Disa nga këto aktivitete mund të përfshijnë:

- Menaxhimi i mediave për sigurimin e komunikimit të saktë për ndikimin e fatkeqësisë, ndërmarrjen e masave lehtësuese dhe krijimin e vullnetit të mirë.
- Angazhimi i komuniteteve me synimin për të parandaluar reagimet e panikut, duke siguruar informata të duhura dhe adresim të pyetjeve për mirëqenie.
- Menaxhimi i reagimeve për të marrë përditësime për masat lehtësuese dhe nevojat urgjente të agjencive të ndryshme në masat lehtësuese emergjente.

Vlerësimi paraprak i dëmeve: Pas një fatkeqësie, Pika kontaktuese të marrë kërkesa të njëpasnjëshme për ndihmë nga shumë njerëz. Kjo do të ishte një situatë e mbingarkesës. Prandaj, është e nevojshme që burimet të shfrytëzohen dhe të vendosen në mënyrën më efikase. Një vendosje e tillë nuk është e mundur pa bërë një vlerësim paraprak të dëmeve. Pasi të ketë ndodhur një fatkeqësi, komuna duhet të kryejë një vlerësim paraprak të nevojave dhe humbjeve dhe të mobilizojë burimet në përputhje me rrethanat.

Komuna do të përgatisë udhëzime për të drejtuar masat e ndihmës emergjente dhe të lehtësimit në këtë fazë. Gjithashtu ajo do të lehtësojë, koordinojë dhe monitorojë këto masa lehtësuese emergjente të cilat kryhen nga agjenci të tjera në fushën e tyre të veprimit. Pika kontaktuese do të fokusojë kryesisht në ofrimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e shërbimeve komunale.

2. Drejtoria e shëndetësisë

- Realizimi dhe shpërndarja e një vlerësimi të rrezikut të popullsisë;
- Zhvillimi i një plani komunal për përgatitje dhe reagim në rast të emergjencave;
- Sigurimi i disponueshmërisë adekuate të Mjeteve të Shëndetit Emergjent në zonat me rrezikshmëri të lartë;
- Trajnimi i vullnetarëve për programet e gatishmërisë në rast emergjence, si ndihma e parë dhe masat parandaluese kundër sëmundjeve;
- Përgatitja e një liste me personelin mjekësor dhe paramjekësor në zonat e prirura për fatkeqësi;
- Krijimi dhe funksionimi i një sistemi për paralajmërim të hershëm për kërcënimet shëndetësore në bazë të informatave shëndetësore rutinore dhe në bashkëpunim me departamentet e tjera;
- Mobilizimi i ekipeve mjekësore dhe personelit paramjekësor për zonat e prekura si pjesë e Ekipeve për vlerësim dhe reagim të shpejtë;
- Ofrimi i ndihmës mjekësore për popullatën e prekur;
- Kryerja e vlerësimeve teknike mbi disponueshmërinë dhe nevojën për infrastrukturë shëndetësore.

3. Drejtoria e arsimit

- Përzgjedhja e vendeve të sigurta në shkolla dhe zbatimi i projektit dhe ndërtimit të qëndrueshëm ndaj fatkeqësive në mënyrë që çdo shkollë e re të jetë e sigurt;
- Zbatimi i skemës së prioritetizimit për përshtatje të mëvonshme dhe zëvendësim (përfshirë zhvendosjen) të shkollave të pasigurta;
- Zvogëlimi i rreziqeve infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore në ndërtesa dhe objekte nga të gjitha burimet, duke përfshirë projektimin dhe planin e brendshëm dhe orenditë e sigurta për mbijetesë dhe evakuim. Përfshini këtu qasjen për aftësi të kufizuara kur keni parasysh këto;
- Nëse shkollat planifikohen si strehimore të përkohshme për komunitetin, të projektohen ashtu që t'i përmbushin këto nevoja;
- Të sigurohet që qasja e fëmijëve në shkolla të jetë pa rreziqe fizike (shtigjet për këmbësorë, vendkalimet në rrugë dhe lumenj);

- Ujësjiellësi dhe kanalizimet të përshtaten për rreziqet potenciale (mbushja me ujë dhe kanalizimet e mbuluara);
- Zbatimi i intervenimeve sipas klimës, si mbledhja e ujërave të shiut, panelet diellore, energjia e rinovueshme, kopshte shkollore;
- Plani për financim dhe mbikëqyrje për mirëmbajtjen e vazhdueshme të objekteve;
- Sigurimi i trajnimeve për mësimdhënës dhe trajnerë të mësimdhënësve për materialet e kurrikulës për zvogëlimin e rrezikut;
- Zhvillimi i strategjive për të përmirësuar përfshirjen e mësimdhënësve në integrimin efektiv të këtyre temave në kurrikulën formale, si dhe qasjet joformale dhe jashtë-kurrikulare me komunitetet lokale;
- Përgatitja e mesazheve kryesore të bazuara në konsensus për zvogëlimin e ndjeshmërisë së familjeve dhe të komunitetit dhe përgatitja dhe reagimi ndaj ndikimeve të rrezikut si bazë për arsimin formal dhe joformal;
- Krijimi i Qendrës për mësim të përkohshëm, pas SSP-së dhe angazhimit të vullnetarëve lokalë si mësimdhënës për të vazhduar shkollimin;
- Vendosja e numrit të nevojshëm të institucioneve arsimore dhe ndërtesave të tyre për t'u shfrytëzuar si strehimore emergjente dhe i qendrave për ndihmë, nëse është e nevojshme;
- Ofrimi i ndihmës vullnetare për shpërndarjen e materialeve lehtësuese dhe asistencës për personat me nevoja të veçanta në lokalitet përmes mësimdhënësve dhe nxënësve.

4. Mirëqenia sociale

- Sensibilizimi i menaxherëve të fatkeqësive në lidhje me fëmijët dhe çështjet gjinore në menaxhimin e fatkeqësive;
- Përgatitja e projekteve të veçanta për përmirësimin socio-ekonomik të grave drejt zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë;
- Organizimi i kampeve shëndetësore për kontrole të rregullta mjekësore të grave dhe ndihma për nevojtarët;
- Organizimi i programeve trajnuese për gratë që të përballen me situata të fatkeqësive;
- Të ndihmohet krijimi i kampeve për segmente të ndjeshme të shoqërisë;
- Sigurimi i pagave minimale për punën e kryer gjatë ofrimit të ndihmës në përmbajtje apo fatkeqësi të tjera.

5. Grupet e komunitetit, OJQ-të, Partnerët ndërkombëtarë

- Përgatitja e planit operacional për menaxhimin e fatkeqësive dhe planit për gatishmëri në rast emergjence sa i përket mandatit;
- Mbatja e trajnimit për vullnetarët në ndihmën e parë, evakuimin dhe reagimin emergjent;
- Mbatja e punëtorive përgatitore për përgatitje në rast të fatkeqësive, me bazë në komunitet dhe trajnimeve për reagim emergjent;
- Organizimi i seminareve dhe punëtorive për çështje të ndërlidhura me fatkeqësitë, për të ndikuar tek qeveria dhe donatorët që të shpërndajnë më shumë burime për lehtësim dhe rimëkëmbje;
- Promovimi i standardeve minimale të Projektit të sferës në përgjigje ndaj fatkeqësive;
- Organizimi i programeve trajnuese përgatitore për raste fatkeqësish, për organizatat me bazë në komunitet, OJQ-të dhe këshilltarët e zgjedhur në nivel të UC-së;
- Përgatitja e materialit IEC për çështje të ndërlidhura me fatkeqësitë për masat parandaluese në gjuhët lokale;
- Hulumtimi i mënyrave dhe zhvillimi i strategjive për të punuar me komunën, drejtoritë dhe EM komunale në kohë të fatkeqësisë dhe jashtë fatkeqësisë.

Faza e reagimit emergjent

- Asistimi i komunës dhe DME-së në procesin e evakuimit në zonat e prekura.

6. Shërbimi i zjarrfikjes

- Përgatitja e një plani për emergjenca, me skenarë të ndryshëm për zonat e banuara në zonat urbane dhe lagjet e varfra në qytetet e mëdha;
- Përgatitja e një plani për emergjenca për zonat industriale, me fokus të veçantë në industrinë kimike;
- Blerja e pajisjeve për zjarrfikje dhe vendosja e stacioneve të zjarrit sipas madhësisë dhe popullsisë në secilin qytet në Kosovë;
- Përgatitja e materialeve IEC në gjuhët kombëtare/lokale për masat parandaluese kundër zjarrit, me mbështetjen e Organizatave Ndërkombëtare dhe AME-ve;
- Organizimi i programeve vetëdijesuese për zjarrin, për mësimdhënësit e shkollave, nxënësit, punëtorët në sektorin industrial formal/joformal, pikat e karburantit, tregjet komerciale etj;
- Identifikimi i vendeve që priren për t'u kapluar nga zjarri në qytet dhe përgatitja e planeve emergjente në përputhje me rrethanat;
- Zhvillimi i një sistemi për monitorimin e rrezikut nga zjarri në lokalitetet urbane;

- Stërvitjet kundër zjarrit të bëhen rregullisht;
- Mbajtja e të gjitha automjeteve të zjarrfikësve në rregull dhe të gatshme për shfrytëzim në çdo kohë dhe kudo;
- Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve dhe palëve të interesit, p.sh. hotelit, restorantit, pronarëve të dyqaneve, pronarëve të pikave të karburantit, rreth rreziqeve potenciale nga zjarri dhe strategjitë për luftimin e zjarrit;
- Zhvillimi i aftësive teknike të vullnetarëve për luftimin e zjarrit;
- Disponueshmëria e ekipeve të zjarrfikësve.

Faza e reagimit emergjent

- Caktimi i ekipeve të zjarrfikësve;
- Shpëtimi i njerëzve;
- Koordinimi me AME, komunën, DOE, DOH, DME.

7. Kryqi i kuq

- Përgatitja e planit operacional për menaxhimin e fatkeqësive dhe planit për gatishmëri në rast emergjence sa i përket mandatit;
- Mbajtja e trajnimit për vullnetarë në ndihmën e parë, evakuimin dhe reagimin emergjent;
- Mbajtja e punëtorive përgatitore për reagim emergjent dhe për përgatitje për fatkeqësi me bazë në komunitet;
- Përgatitja e planeve zhvillimore në bashkëpunim me AME-në dhe DME-në;
- Përgatitja e një regjistri të vullnetarëve për të dhuruar gjak në nivele të degëve dhe të zyrës qendrore dhe e ndarja e atij regjistri me AME dhe DME;
- Zhvillimi i ekipeve të vullnetarëve për përgatitje dhe reagim ndaj fatkeqësive.;
- Trajnimi i vullnetarëve në përgatitjen dhe reagimin në rast emergjencash (p.sh., evakuimi, ndihma e parë, zjarrfikja, paralajmërimi i hershëm etj.);
- Zbatimi i programeve në nivel të komunitetit për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, një përgatitje që përfshin stërvitjet dhe simulimet.

Faza e reagimit emergjent

- Asistimi i komunave, AME-së dhe DME-së në procesin e evakuimit në zonat e prekura;
- Sigurimi i ambulancave për shpëtim dhe transportim të personave të lënduar;
- Sigurimi i shërbimeve mjekësore për popullatën e prekur;
- Koordinimi me AME-në, komunën, ORND-të, OKB-në, agjencitë ndihmuese për reagim emergjent;
- Koordinimi me autoritetet e EM-së dhe agjencitë e OKB-së për punë lehtësuese pas fatkeqësive.

8. Spitalet

- Përgatitja e planit për përgatitjen e spitalit;
- Zhvillimi i kapacitetit të spitalit në përgatitjen dhe reagimin në rast të fatkeqësive;
- Kryerja e trajnimit për personelin e ndihmës së parë, evakuimin dhe reagimin emergjent.

Reagimi emergjent

- Kontrollimi i sigurisë së ndërtesave dhe objekteve spitalore dhe konfirmimi i sigurisë së përdorimit të spitalit për operacione emergjente;
- Sigurimi i shërbimeve mjekësore për personat e lënduar;
- Koordinimi me AME-në, MSH-në, komunën, OJQ-të, ORND-të, agjencitë ndihmuese për reagim emergjent;
- Koordinimi me autoritetet e EM-së dhe agjencitë e OKB-së për punë lehtësuese pas fatkeqësive.

9. Shkollat

- Sigurimi i politikave, udhëzime në nivele shkollor për vlerësimin dhe planifikimin e vazhdueshëm në vend, për zvogëlimin e rrezikut dhe gatishmërinë për reagim, si pjesë e menaxhimit normal dhe përmirësimit të shkollës;
- Zhvillimi, shtrirja, institucionalizimi, monitorimi dhe vlerësimi i krijimit ose fuqizimit të komisionit për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në shkolla, duke përfshirë personelin, nxënësit, prindërit dhe palët e interesit;
- Përshtatja e procedurave standarde të funksionimit sipas nevojës, për rreziqet me dhe pa paralajmërime, duke përfshirë: “shtrihu, mbulo dhe mbaju”, ndërtimi i shtigjeve për evakuim, evakuimi në strehë të sigurt, strehimi në vend dhe bllokimi, dhe ribashkimi i sigurt me familjen;
- Të praktikohet dhe të përmirësohet gatishmëria e reagimit me stërvitje simulimi të rregullta në shkolla dhe të lidhura me komunitetin;
- Krijimi i planeve emergjente komunale dhe të shkollave, për të mbështetur vazhdimësinë arsimore, duke përfshirë planet dhe kriteret për të kufizuar përdorimin e shkollave si strehimore të përkohshme;
- Përfshirja e nevojave të fëmijëve parashkollorë dhe atyre jashtë shkollës, fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe të vajzave dhe djemve;
- Zhvillimi i fushëveprimit dhe rendit për mësimdhënie lidhur me rreziqet, fatkeqësitë dhe zgjidhjen e problemeve për zvogëlimin e rrezikut;
- Stimulimi për zvogëlimin e rrezikut përgjatë kurrikulës dhe sigurimi i udhëzimeve për integrimin e ZRRF-së në lëndët përkatëse.

9. Shtojcat

Shtojca A: TERMAT E REFERENCËS

1. HISTORIKU:

“Save the Children” është organizatë e pavarur, liderë në botë, për fëmijë. Ne punojmë në rreth 120 vende. Ne mbrojmë jetën e fëmijëve; luftojmë për të drejtat e tyre; u ndihmojmë ta arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Ne punojmë për të inspiruar ndryshime në mënyrën se si bota i trajton fëmijët dhe për të arritur ndryshime të menjëhershme dhe afatgjata në jetën e tyre. Në gjithë punën tonë, ne ndjekim disa vlera kryesore: llogaridhënie, ambicie, bashkëpunim, kreativitet dhe integritet.

2. FUSHËVEPRIMI:

“Save the Children International” Zyra në Kosovë (SCI Kosovë), si pjesë e projektit të saj “Promovimi i komuniteteve të qëndrueshme ndaj fatkeqësive dhe më të sigurta në Kosovë përmes ZRRF-së gjithëpërfshirëse të fokusuar tek fëmija”, synon të angazhojë një Ekspert Ndërkombëtar për të bërë vlerësime mbi legjislacionin dhe politikën, në mënyrë që të sqarohen rolet dhe përgjegjësitë e departamenteve të ndryshme në Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (ZRRF) në nivel komunal. Nëpërmjet këtij raporti, SCI Kosovë kërkon të dalë me versione të duhura për legjislacionin dhe politikën e lidhura me ZRRF-në, për të qartësuar ato role dhe përgjegjësi në nivel komunal.

3. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR PROJEKTIN:

“Promovimi i komuniteteve të qëndrueshme ndaj fatkeqësive dhe më të sigurta në Kosovë përmes ZRRF-së gjithëpërfshirëse me fokus tek fëmija” është një projekt njëvjeçar i financuar nga “Save the Children Itali”.

Përmes këtij projekti, SCI Kosovë synon të rrisë qëndrueshmërinë e fëmijëve, duke përfshirë fëmijët nga grupet e marginalizuara, familjet e tyre, edukatorët dhe komunitetet ndaj fatkeqësive natyrore dhe krijimin e një mjedisi më të sigurt për fëmijët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e tjerë të marginalizuar, në ambiente parashkollore dhe të arsimit fillor, përmes promovimit të qasjeve inovative dhe të qëndrueshme për arsimin e ZRRF. Projekti do të punojë në katër (4) shkolla, në katër (4) komuna të ndryshme në Kosovë (duke përfshirë: Prishtinën, Prizrenin, Pejën dhe Mitrovicën).

4. QËLLIMI:

Ekzistojnë paqartësi të mëdha në rolet dhe përgjegjësitë e ZRRF-së lidhur me punën e institucioneve të ndryshme shtetërore dhe komunale në Kosovë. Prandaj, SCI Kosovë është duke angazhuar një Ekspert Ndërkombëtar (që këtej e tutje i referohemi “Konsulenti”), i cili do të bëjë një rishikim të legjislacionit dhe të politikave ekzistuese, me synimin që të qartësojë rolet dhe përgjegjësitë e departamenteve të ndryshme në ZRRF në nivel komunal dhe të dalë me një version të legjislacionit të lidhur me ZRRF-në, me qëllim që të sqarojë ato role dhe përgjegjësi në nivel komunal.

5. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

Përmes mbështetjes dhe koordinimit me SCI Kosovë, Konsulenti pritet të kryejë detyrën e mëposhtme:

- Rishikimi dhe analizimi i situatës ekzistuese në përgjithësi lidhur me legjislacionin, politikat dhe praktikën e ZRRF-së në Kosovë.
- Zhvillimi i instrumenteve për intervistim.
- Mbledhja e të dhënave.
- 4 intervista me zyrtarët përgjegjës të ZRRF në nivel komunal.
- Dorëzimi i një raporti gjithëpërfshirës dhe analitik që reflekton situatën aktuale në ZRRF dhe të dalë me një version krahasimor për legjislacionin e lidhur me ZRRF, për të sqaruar ato role dhe përgjegjësi në nivel komunal.

Rezultatet duhet të përshkruajnë:

- Objektivat e vlerësimit;
- Përmbledhjen e metodologjisë;
- Burimet e të dhënave;
- Listën e individëve të intervistuar dhe të grupeve të interesit dhe/ose të komuniteteve që janë konsultuar;
- Listën e dokumenteve mbështetëse që janë rishikuar;
- Të gjeturat dhe përfundimet.

6. AFATI KOHOR DHE KOHËZGJATJA E KËTIJ ANGAZHIMI:

Detyrat	Ditë
Analiza, rishikim & intervista	3 ditë
Përgatitja e raportit	2 ditë
Gjithsej	5 ditë

Kjo detyrë do të kryhet gjatë muajit korrik/gusht 2015, në Kosovë. Raporti duhet të dorëzohet jo më larg se tridhjetë (30) ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes.

7. APLIKIMI:

Ju lutem, aplikoni përmes email-it më së largu më 17 korrik 2015 në ora 16:00 tek SCI Kosove në adresën scik@savethechildren.org.

Shtojca B: Lista e personave të intervistuar

Emri	Pozita	Departamenti
Z. Fadil Kodra	Shef	AME
Z. Labinot.sadiku	Zyrtar i lartë	Divizioni për Siguri në Komunitet – Departamenti për Siguri Publike – industria e Punëve të Brendshme
Z. Arbër Salihu	Zyrtar për kurrikulë	Divizioni i Kurrikulave - MASHT
Znj. Lulavere Behluli	Shefe e Divizionit	Divizioni për Arsimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta – MASHT
Znj. Ajmane Barani	Drejtoreshë	MED (Mitrovicë)
Z. Dren Rexha	Zyrtar i lartë	UNICEF
Znj. Zana Hoxha	Zyrtare e lartë	UNDP
Z. Hamdi Shyti	Drejtor i shkollës	Shkolla “Migjeni” (Mitrovicë)
Z. Musa Dragaj	Drejtor	Drejtoria komunale për mbrojtje dhe shpëtim (Mitrovicë)
Z. Bahtir Maxhuni	Zyrtar i lartë	Drejtoria komunale për mbrojtje dhe shpëtim (Mitrovicë)
Z. Barduyl Sylja	Shef i stafit	MED (Gjilan)
Znj. Liridona Ukshini	Zyrtare për gjithëpërfshirje	MED (Gjilan)
Z. Fatmir Yelimi	Drejtor i shkollës	Shkolla “Selami Hallaqi” – (Gjilan)
Z. Hetem Kosumi	Drejtor i shkollës	Shkolla “Abaz Ajeti” (Gjilan)
Znj. Emina Kosumi	Zëvendës drejtoreshë e shkollës	Shkolla “Abaz Ajeti” (Gjilan)

Shtojca C: Lista e dokumenteve të shqyrtuara

Plani Strategjik për Arsim i Kosovës 2011-2016

Ligji për Vetë-qeverisje Lokale

Sistemi i Integruar për Menaxhimin e Emergjencave

Plani për Reagim Kombëtar në Kosovë 2010

Raporti i UNDP-së për MRRF-në e integruar në Zhvillim

Projekt dokumenti “Iniciativa për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë në Kosovë (KDDRI)”

UNDP-Raporti i Vlerësimit të Kapaciteteve për Zvogëlimin e Rrezikut në Kosovë

UNDP- Rishikimi i trendëve aktuale në menaxhimin e legjislacionit të ZRRF-së

Manuali i Sigurisë për Organizatën e Fëmijëve për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – Misioni në Kosovë

PROGRAMI I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2015-2018

Vlerësimi i Nevojave të Përfituesve të IPAs nga UNDP, EMO dhe BE

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I VETË-QEVERISJES LOKALE NË KOSOVË

Udhëzuesi për zbatimin e politikës kombëtare për riintegrim

Ligji nr.04-l-230 për Agjencinë për Menaxhim të Emergjencave

Ligji për mbrojtjen kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera

Ligji për zjarrfikje dhe shpëtim

Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri

Rregullorja nr. 16/2012 për strukturën organizative të njësive profesionale për zjarrfikje dhe shpëtim

Rregullorja nr. 08/2013 për përmbajtjen dhe procedurat për hartimin e planeve për reagim emergjent

Rregullorja GRK - nr. 18/2013 për organizimin dhe funksionimin e sistemit për monitorim, njoftim dhe paralajmërim

Udhëzimi Administrativ nr. 01/2013 për hetimin, mbikëqyrjen e zbatimit të masave për mbrojtje nga zjarri

Udhëzimi Administrativ nr. 18/2010 për organizimin dhe strukturimin e Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave

Udhëzimi Administrativ nr. 01/2013 për emblemën e Agjencisë për menaxhimin e Emergjencave

Shtojca D: Pyetëtori

A. Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (në nivel kombëtar)

1. Cilat janë dokumentet e politikave të qeverisë lidhur me zvogëlimin e rrezikut dhe me reagimin - përballë fatkeqësive natyrore?
 - Plani Kombëtar i Reagimit për Menaxhimin e Fatkeqësive
 - Rendi i Përhershëm për Fatkeqësi (SOD)
 - Udhëzimet për qeverinë në të gjitha nivelet (modelet më të mira të praktikës)
 - Kodet e ndërtimit, veçanërisht për shkollat
2. Si i zbaton qeveria politikat lidhur me zvogëlimin, gatishmërinë dhe reagimin ndaj rrezikut nga fatkeqësitë?
3. Çfarë buxheti ka alokuar qeveria për ZRRF-në? Cilat institucione ekzistojnë? Cili është niveli i personelit në këto institucione?
4. Cilat ishin përpjekjet e qeverisë për ndërtimin e kapaciteteve të niveleve të ndryshme të qeverisë për zbatimin e politikave të qeverisë për zvogëlimin e rrezikut dhe reagimin ndaj fatkeqësive?
5. Cila do të jetë strategjia dhe plani i qeverisë për ndërtimin e kapaciteteve të DMC-ve lokale në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe politikat që lidhen me menaxhimin e reagimit?
6. Cilat janë sistemet për monitorimin e zbatimit të politikave qeveritare (SOD) në nivel të qeverisjes lokale?
7. Çfarë mbështetjeje (financiare dhe teknike) i ofron qeveria DMC-ve lokale në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut të komunitetit?
8. Cili është sistemi/mekanizmi për integrimin e planeve të qeverisjes lokale për ZRRF në procesin kombëtar të qeverisë për planifikim zhvillimor?
9. Cili është kapaciteti i departamentit meteorologjik për të monitoruar ndryshimet klimatike? Sa i dendur është rrjeti i stacioneve të monitorimit? A po bëhet ndonjë punë parashikimi modeluese në Departamentin Meteorologjik? Si merret informata rreth parashikimit të motit?
10. Cila është strategjia e qeverisë për ngritjen e vetëdijes së vendimmarrësve dhe të planifikuesve zhvillimorë për integrimin e ZRRF-së në procesin e planifikimit zhvillimor?
11. Cila është politika ekzistuese për alokimin e burimeve për DMC-të e qeverisjes lokale për zbatimin e planeve përkatëse për zvogëlim të rrezikut dhe për reagim?
12. Cili është sistemi i qeverisë në lidhje me rritjen e vetëdijesimit të popullsisë së komunitetit (rural/urban) për paralajmërimin e hershëm dhe gatishmërinë shtëpiake për t'u përballë me rreziqet e ndryshme natyrore?

B. Ministria e Arsimit

1. Cila është politika e qeverisë lidhur me sigurimin e shkollave rurale dhe urbane nga rreziqet natyrore dhe për vazhdimin e arsimit pas një fatkeqësie?
2. Cila ministri/cili departament është përgjegjës për projektimin, ndërtimin dhe përshtatjen e shkollave fillore dhe të mesme?
3. A është bërë ndonjë vlerësim për të matur sigurinë e ndërtesave/strukturave shkollore dhe përshtatjen e tyre apo rindërtimin?
4. Kush (Ministria/Departamenti) është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ndërtimit dhe për të siguruar që kodet e ndërtimit dhe standardet e sigurisë respektohen në procesin e ndërtimit?
5. Çfarë roli ka administrata lokale, qeverisja vendore, SMC apo komuniteti për të siguruar cilësinë e procesit të ndërtimit të shkollave? A ka ndonjë udhëzim të shkruar të politikave në lidhje me këtë?
6. Çfarë roli duhet të ketë MA për të siguruar që strukturat e shkollës të jenë të sigurta për nxënësit, mësimmshënësit dhe personelin e shkollës?
7. Cili është perceptimi i MA lidhur me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë të bazuara në shkollë (SBDRR)/Siguria në shkollë?
8. Cilat udhëzime u janë dhënë departamenteve përkatëse lidhur me SBDRR-në?
9. Çfarë mbështetje ofrohet nga Ministria tek departamentet e tyre përkatëse lidhur me SBDRR-në?
10. Kush jep mbështetje teknike për SBDRR-në në departamentet përkatëse të MA-së? Çfarë lloj mbështetje është ofruar?
11. A e parasheh MA një rol për shkollat fillore dhe të mesme/nxënësit dhe mësimmshënësit në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në nivel komuniteti dhe procesin e adaptimit me ndryshime klimatike? Si mund të bëhet kjo?
12. Çfarë rolesh po luajnë ose mund të luajnë universitetet në zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe efektet klimatike të vendit?
13. A është organizuar/mbajtur ndonjë takim koordinues në nivel kombëtar me zyrtarët e arsimit në nivel kombëtar dhe lokal, mësimmshënësit në shkollë, nxënësit dhe praktikuesit e ZRRF-së për të ndarë mësimet nga terreni dhe për të kërkuar ide të reja?
14. A ka lidhje të sigurisë në shkollë dhe komunitetit? Lidhja midis SBDRM-së dhe MRRFBK-së?
15. A kanë shkollat planet e sigurisë së shkollës? A organizohen rregullisht stërvitje në shkollë?
16. A kanë shkollat kuti për siguri në shkollë?

C. Drejtori i shkollës në nivel komunal

1. Cila është strategjia dhe planet e departamentit për ta bërë të sigurt shkollën në zonat rurale/urbane nga rreziqet natyrore dhe vazhdimi i arsimit pas një fatkeqësie?

Siguria strukturore - të garantohet se strukturat ekzistuese janë të sigurta?

Siguria jo-strukturore - vlerësimi i sigurisë në shkollë, planifikimi i zvogëlimit të rrezikut, siguria e nxënësve gjatë dhe pas një ngjarjeje fatkeqësie, vazhdimi i arsimit dhe sigurimi i materialeve mësimore të humbura.

2. A ka departamenti një person të caktuar për udhëheqjen e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë me bazë në shkollë/siguria në shkollë?
3. Si lidhet departamenti me Departamentin për Menaxhimin e Fatkeqësive (DMF) dhe CDMP? Çfarë mbështetje merret/kërkohe nga këto departamente në lidhje me Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë/?
4. Cilat manuale, udhëzime dhe materiale të EIE janë zhvilluar ose janë duke u zhvilluar lidhur me udhëzimin e SMC, mësimdhënësve dhe nxënësve për sigurinë strukturore dhe jo-strukturore të shkollave nxënësve, d.m.th. procesi i zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në shkollë.
5. Kush ka/është duke siguruar mbështetje teknike të kërkuar për Departamentin e Arsimit në zhvillimin e strategjisë dhe materialeve për SBDRR/Sigurinë në Shkollë? Çfarë mbështetje tjetër do të jetë e nevojshme?
6. A mendon departamenti se Procesi i Sigurisë në Shkollë/SBDRR mund të zbatohet përmes strukturave ekzistuese qeveritare të Departamentit të Arsimit?
7. Cila do të jetë strategjia për shtrirjen e procesit SBDR nga niveli kombëtar në nivel shkolle? p.sh. Përgjegjësitë e departamentit në nivele të ndryshme?
 - Si do të trajtohen zyrtarët/stafi i arsimit në nivele të ndryshme?
 - Si do të trajtohen SMC, mësimdhënësit dhe nxënësit?
 - Si do të monitorohet procesi në nivele të ndryshme?
 - Cilat do të jenë fazat dhe plani për implementim?
8. Cilat burime financiare janë ndarë apo do të ndahen për të mbështetur departamentet arsimore të nivelit lokal dhe shkollat për zbatimin e SBDRR në shkollë?
9. Cila është strategjia dhe plani për lidhjen e ZRRF-së së shkollës dhe planit CP me Planin e Departamenteve të Arsimit?
10. Cila është strategjia dhe plani për ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve në lidhje me temat e mësimdhënies që lidhen me menaxhimin e fatkeqësive dhe ndryshimeve klimatike për nxënës?

11. A parashikon departamenti një rol të shkollave/nxënësve në ZRRF dhe procesin e përshtatjes së ndryshimeve klimatike në nivel komuniteti? Si mund të realizohet kjo?
12. A ka pasur ndonjë takim koordinimi në nivel qendror me zyrtarët e arsimit në nivel kombëtar dhe lokal, mësuesit dhe nxënësit e shkollave, praktikuesit e ZRRF-së për të ndarë përvojat dhe për të mësuar nga njëri-tjetri në ZRRF/ Siguria e shkollave?
13. A ka ndonjë sistem paralajmërimi të hershëm të praktikuar nga departamenti? Si merret informata në lidhje me fatkeqësitë në shkolla?



SAVE THE CHILDREN IN KOSOVA/O

Rr. Gazmend Zajmi, no 01

10000 Prishtinë, Kosova/o

Tel: +383 (0) 38 23 26 91

Email: scik@savethechildren.net

www.kosovo.savethechildren.net

<https://www.facebook.com/savethechildreninkosova/o>